

*Janar / Shkurt / Mars / 2017*

## Zhvillohet mbledhja e radhës së Komitetit të Monitorimit të fondeve të Instrumentit për Asistencën e Para-anëtarësimin (IPA)

Tiranë, 18 janar 2017

Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC), përfaqësues të lartë të Komisionit Europian dhe aktorë të shoqërisë civile, morën pjesë në mbledhjen e Komitetit të Monitorimit të fondeve të Instrumentit për Asistencën e Para-anëtarësimin (IPA), të organizuar nga Ministria e Integritimit Europian, znj. Klajda Gjoshja.

Në fjalën e saj, znj. Gjoshja u shpreh se BE do të japë për Shqipërinë 19.1 milionë euro, nga të cilat 10 milionë do të shkojnë për zbatimin e Vetting-ut.

Gjithashtu shtoi se për herë të parë, Shqipëria nuk ka asnjë projekt problematik, ndryshe nga një vit më parë, ku ishin 7 projekte të parealizuara.

Edhe përfaqësuesit e Komisionit Europian vlerësuan progresin e arritur nga Shqipëria, progres i cili përkthehet dhe në zbatimin e projekteve të IPA-s.



**Marrëveshje Bashkëpunimi dhe Partneriteti Akademik ndërmjet  
Institut für Polizei - und Sicherheitsforschung (IPoS), Bremen Gjermani  
dhe Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC)**



Më 19 nëntor 2016, përfaqësuesi i Institut für Polizei- und Sicherheitsforschung (IPoS) në Universitetin e Shkencave të Aplikuara për Administratën Publike, Bremen, Gjermani, Prof. Dr. Arthur Hartmann dhe Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), z. Andi Kananaj, nënshkruan marrëveshjen e Bashkëpunimit dhe Partneritetit Akademik midis dy institucioneve.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi dhe Partneriteti Akademik do të shërbejë qëllimit të thirrjes për Propozime, në kuadër të zbatimit të Strategjisë së Qeverisë Federale, për Ndërkombëtarizimin e Rregulloreve, mbi Shkencën dhe Punën Kërkimore, të cilat drejtojnë

programin e financimit "Bashkëpunimi Ndërkombëtar në Arsimit dhe Kërkim Shkencor - Rajoni i Evropës Juglindore, Qendrore dhe Lindore".

Marrëveshja e Bashkëpunimit dhe Partneritetit Akademik përfshin masat për iniciimin e një bashkëpunimi të ri akademik në fushën e Ligjshmërisë dhe Sigurisë Evropiane, në kontekstin sociologjik dhe politik.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi dhe Partneriteti Akademik shtrihet në të gjitha fushat kryesore, por jo vetëm, të tilla si iniciimi i projekteve të përbashkëta në fushën kërkimore dhe botuese, sigurimi i financimeve të tjera për projekte të përbashkëta, workshope, shkolla

verore, leksione, seminare, në shkëmbimin e stafëve akademike, si dhe në shkëmbimin e studenteve në të gjitha nivelet.

Në bazë të kësaj marrëveshje, palët u angazhuan se do të forcojnë, intensifikojnë dhe çojnë me tej partneritetin dhe bashkëpunimin akademik, do të ndërmarrin iniciativë të përbashkëta në të mirë të publikut si dhe do të jenë të barabarta në iniciimin e projekteve të përbashkëta. Ato kanë të drejta të pakushtëzuara për të pasur qasje të plotë ndaj burimeve akademike.

Kjo marrëveshje është e pa limituar në kohë dhe hyri në fuqi me nënshkrimin e saj.

## AMSHC merr pjesë në tryezën e konsultimit publik për paketën e ligjeve antikorrupsion

Tiranë, 27 janar 2017



Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) morën pjesë në një tryezë konsultimi publik për projektligjet e paketës antikorrupsion, e cila u mbajt në kuadër të reformës në drejtësi nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Tryeza drejtohej nga deputetët e Komisionit, njëkohësisht dhe relatorë të projektligjeve, z. Pandeli Majko dhe z. Ulsi Manja.

Në këtë takim ishin të pranishëm ekspertë të nivelit të lartë, vendas dhe ndërkombëtarë, përfaqësues të institucioneve publike, deputetë, prokurorë, avokatë, përfaqësues të shoqërisë civile si dhe pedagogë e studentë të drejtësisë.

Pas prezantimeve, tryeza vazhdoi me diskutime dhe komente nga të pranishmit, lidhur me paketën e projektligjeve të paraqitura.

Në përfundim të takimit deputetët i ftuan pjesëmarrësit që komentet dhe propozimet e tyre t'i përcjellin pranë Komisionit për Çështjet Ligjore, me qëllim që të përfshihen dhe të vlerësohen gjatë diskutimit të projektligjeve në këtë komision.

## Zhvillohet mbledhja e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC)

Tiranë, 15 shkurt 2017

Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC) zhvilloi një mbledhje pranë mjediseve të Kryeministrisë, e cila u drejtua nga Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, z. Blendi Klossi në cilësinë e Kryetarit të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile.

Në mbledhje u ftuan të merrnin pjesë edhe organizata të shoqërisë civile dhe media.





## Ndarja e çmimeve të performancës në shërbimet publike 2016, vlerësuar me instrumentin “Vizitat e Klientit Misterioz”, me financim të AMSHC-së

Tiranë, 28 shkurt 2017



Përfaqësues të AMSHC-së, Drejtori Ekzekutiv, z. Andi Kananaj dhe znj. Desareta Lameborshi morën pjesë në aktivitetin përmbyllës të projektit “Vizitat e klientit misterioz” - Platformë vlerësimi për të përmirësuar shërbimet publike me në qendër qytetarin, i cili u organizua në qendrën publike të inovacionit “Innovation Hub”.

Ministria e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, znj. Milena Harito, dhe Instituti për Kërkime dhe

Alternativa Zhvillimi (IDRA), prezantuan gjetjet e projektit “Çmimet e ekselencës për Shërbimet Publike 2016”, projekt i financuar nga AMSHC.

Pas përfundimit të prezantimit të gjetjeve, u zhvillua edhe ndarja e çmimeve për institucionin më të mirë në ofrimin e shërbimeve publike 2016.



## Hidhet shorti për kohëzgjatjen e mandateve të anëtarëve të shoqërisë civile të KKSHC-së

Tiranë, 1 mars 2017

Në ambjentet e AMSHC-së u mbajt një takim i anëtarëve të shoqërisë civile të Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile (KKSHC), në të cilin u zhvillua hedhja e shortit për përcaktimin e kohëzgjatjes së mandateve të tyre.

Nga hedhja e shortit ndarja e mandateve është si më poshtë:

- |                        |                   |
|------------------------|-------------------|
| 1. Z. Altin Hazizaj    | - Mandat 1 vjeçar |
| 2. Znj. Mirela Koçi    | - Mandat 1 vjeçar |
| 3. Znj. Migena Shulla  | - Mandat 1 vjeçar |
| 4. Znj. Artemisi Shehu | - Mandat 1 vjeçar |
| 5. Znj. Emanuela Zaimi | - Mandat 2 vjeçar |
| 6. Znj. Iris Luarasi   | - Mandat 2 vjeçar |
| 7. Z. Ali Coka         | - Mandat 2 vjeçar |
| 8. Znj. Erisa Lame     | - Mandat 2 vjeçar |
| 9. Z. Luan Ahmetaj     | - Mandat 3 vjeçar |
| 10. Znj. Zana Vokopola | - Mandat 3 vjeçar |
| 11. Z. Ergys Gezka     | - Mandat 3 vjeçar |
| 12. Z. Blendi Dibra    | - Mandat 3 vjeçar |
| 13. Z. Vladimir Thano  | - Mandat 3 vjeçar |



Për arsye pune dhe se ndodhet jashtë vendit, znj. Migena Shulla njofton dorëheqjen e saj nga antarësia e KKSHC-së.

Në vijim, në bazë të rezultateve përfundimtare të numërimit të votave për anëtarët e KKSHC-së, pas votimit elektronik, të publikuar më datë 13.06.2016, për fushën e veprimit “C. Përmirësimi i mirëqenies, shërbimeve sociale, mbrojtjes së shëndetit si dhe cilësisë së jetës”, mandati i kalon personit të radhës, znj. Afërdita Seiti, e cila renditet në vendin e pestë, me 30 vota të vlefshme.

## AMSHC merr pjesë në një vizitë 10-ditore në Kinë, në kuadër të programit “Njohje për Kinën”

Pekin (Kinë), 19 - 28 mars 2017

Me ftesë të Shoqatës Kineze për Mirëkuptim Ndërkombëtar (China Association for International Understanding – CAFIU), Drejtori Ekzekutiv i AMSHC-së, z. Andi Kananaj mori pjesë në një vizitë 10-ditore në Kinë, në kuadër të programit “Njohje për Kinën”, e cila u mbajt në Pekin dhe Jiangxi, në datat 19 – 28 mars 2017.

Delegacioni 18 anëtarësh përbëhej nga organizata të shoqërisë civile (OSHC), Think Tank dhe përfaqësuesit e mediave nga Polonia, Shqipëria, Kroacia, Sllovakia dhe Sllovenia.

Ky program, nëpërmjet organizimit të takimeve me ekspertë dhe studiues kinezë, vizita në institute akademike, kompani etj., synon thellimin e njohjes së përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile të disa prej vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore si dhe diskutimin e temave të ndryshme si: Bashkëpunimi mes Kinës dhe Vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore, iniciativa “Brez dhe rrugë (Belt and Road)”, “Bashkëpunimi 16+1”, mundësia e shkëmbimeve e bashkëpunimeve ndërmjet organizatave të shoqërisë civile etj..

Në këtë takim, nga secili vend pjesëmarrës, u diskutuan temat:

**1. Zhvillimi i OShC-ve gjatë viteve të fundit:**


Burimi i financimit, mënyrat e operimit, fushat kryesore, ligjet dhe rregulloret për OShC-të, aktivitetet rajonale dhe ndërkombëtare të këtyre organizatave.

**2. Prezenca dhe veprimtaria e OShC-ve të huaja:**

Vendet, zonat dhe aktivitetet e këtyre OShC-ve; Marrëdhëniet e këtyre OShC-ve me qeverinë lokale dhe njerëzve.

**3. Perceptimi mbi OShC-të:**

Imazhi social dhe njohja dhe përfshirja e njerëzve lokalë.





## Prezantimi i raportit të parë mbi transparencën e institucioneve të pushtetit ekzekutiv në Shqipëri, i realizuar nga Lëvizja MJAFT!

Tiranë, 30 mars 2017



Përfaqësues nga AMSHC morën pjesë në prezantimin e raportit të parë mbi transparencën e institucioneve të pushtetit ekzekutiv në Shqipëri, studim i realizuar në muajt e fundit nga Lëvizja MJAFT!.

Ky prezantim u zhvillua në kuadër të projektit "Llogaridhënia, Teknologjia dhe Rrjeti i Hapjes Institucionale në Europën Juglindore - ACTION SEE", i financuar nga Komisioni Europian.

Projekti zhvillohet në 6 vendet e rajonit (Mali i Zi, Maqedonia, Bosnja & Hercegovina, Serbia, Kosova dhe Shqipëria), një bashkëpunim i Lëvizjes MJAFT! me organizatat partnere, ku si qëllim kryesor është mbledhja sistematike e informacioneve.

ACTION SEE është hartuar mbi bazën e eksperiencave të partnerëve të rajonit të përfshirë në këtë projekt, i cili synon fuqizimin e organizatave të shoqërisë civile për angazhim efektiv në procesin e politikë-bërjes.

Projekti parashikon ekspertizë dhe njohuri të fituara të partnerëve gjatë implementimit të përbashkët të një sërë aktiviteteve në të gjithë rajonin e Europës Juglindore, të cilat kanë për qëllim sundimin e ligjit dhe qeverisjen e mirë.